

# **STATUTI I SHOQERISE “Anchor Investments” SHPK**

Me cilesine e ortakut Ervin Celaj sot me date 24.01.2017 duke u mbeshtetur:Ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodit Civil ne fuqi,Ne ligjin 9901 date 14.04.2008,“Per shoqerite tregtare”Ne ligjin “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”ne ate Doganor,Fiskal e Tatimor,deklaroj Statutin e Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar me emertimin **“Anchor Investments” SHPK** (me poshte e quajtur “Shoqeria”)

## KREU I

### NENI 1

#### Krijimi

Shoqeria **“Anchor Investments”SHPK** eshte person juridik i te drejtes shqiptare,Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar(me poshte e quajtur “Shoqeria”)

### NENI 2

#### Personaliteti juridik

Shoqeria fiton personalitetin juridik ne date e regishtimit ne QKB, ne perputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria,eshte pergjegjese ndaj te treteve per detyrimet dhe demet e shkaktuara gjate veprimtarise se saj.

Shoqeria **“Anchor Investments”SHPK**,eshte nje e tille,kapitali i se ciles ndahet ne kuota dhe qe themelohet nga ortaku i vetem qe perballon humbje vetem deri ne kufirin e vleres se kontributit te tij ne kapitalin themeltar.

### NENI 3

#### SELIA

Shoqeria e ka seline ne Tirane,Ruga “Themistokli Germanji”Amabasador 1,Tirane.

Shoqeria ka te dreje te ndryshoje seli te hape zyra perfaqesie,filial,e dege si brenda ashtu edhe jashte territorit te Republikes se Shqiperise,vetem me Vendim te Ortakut te Vetem.



#### NENI 4

##### Objekti i veprimitarise

Objekti i veprimitarise se shoqerise eshte:

**1.Aktivitete ne fushen e ndertimit, rikonstrukzionit te veprave publike dhe private,mirembajtje te pasurive te paluajtshme publike dhe private.**

#### NENI 5

##### Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te papercaktuar.

#### **KREU II**

#### NENI 6

##### Kapitali

Kapitali i shoqerise eshte 100.000 leke dhe eshte i ndare ne 1 kuote,vlera nominale e te cilave eshte 100,000 leke.Kapitali i shoqerise zoterohet nga Ervin Celaj ,qe perbejne 100% te kapitalit themeltar te shoqerise.Kapitali i mesiperm eshte nenshkruar dhe shlyer teresish ne te holla nga ortaku i shoqerise.

Pjeset e kapitalit themeltar nuk mund te perfaqesohen nga letra me vlore te tregtueshme dhe as me kontribute ne sherbime.Ortaku per gjigjet per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontibutit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

#### NENI 7

##### Zmadhimi e zvogelimi i kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit themeltar per kontributet ne para dhe me ane te kontributiveve ne natyre,nepermjet emerimit te ekspertit te autorizuar per keto kontribute ne natyre sipas kerkeses se administratorit.

Zvogelimi i kapitalit realizohet me vendim te Ortakut te Vetem ne te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit.Projekti i zvogelimit te kapitalit u komunikohet eksperteve kontabel te autorizuar,ne rast se ka te tille,45 dite perpara dates se mbledhjes se Ortakut te Vetem te thirrur per te marre vendim rrith ketij projekti.



Zvogelimi i kapitalit themeltar ne nje vlore me te vogel se ajo e percaktuar ne nenin 6 te ketij statuti,e ben te detyrueshme marrjen e nje vendimi prej shoqerise per zmadhimin e kapitalit themeltar te pakten deri ne vleren nominale.Ne te kundert shoqeria duhet te shnderrohet ne nje forme tjeter.Ne rast mosbatimi te kerkesave te ketij paragrafi,cdo personi interesuar mund te kerkoje ne rruge gjyqesore prishjen e shoqerise.Kjo prishje nuk mund te shpallet,ne qofte se rregullimi eshte bere ne diten kur gjykata mblidhet per te marre vendim.

### NENI 8

#### Transferimi i kapitalit

Pjeset e kapitalit themeltar mund tu transferohen personave te trete qe nuk bejne pjese ne shoqeri,vetem me miratimin e Ortakut te Vetem.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie.Ato Jane transferueshme edhe ne rast ndarje pasurore mes bashkeshorteve.Gjithashtu Jane te transferueshme ndermjet bashkeshorteve,si dhe ndermjet paraardhesve,nepermjet akteve ligjore.

### KREU III

#### ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

### NENI 9

#### Organi Vendimmarres

Ortaku i Vetem eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Ortaku i Vetem eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteteve te percaktuara ne ligj.

Ortaku i Vetem brenda nje afati prej gjashte muajsh,duke filluar nga data e mbylljes se vitit finanziar,miraton raportin e administrimit,inventarin,bilancin dhe llogarite vjetore,te hartuara nga administratori.Ai mund te perfaqesohet edhe nga nje person tjeter,nepermjet prokures.

### NENI 10

#### Ndryshimet ne Statut

Ndryshimet ne statut vendosen nga ortaku i vetem.

Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet ne QKB per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

## NENI 11

### Administrimi

Administratori i shoqerise emerohet dhe shkarkohet vetem me vendim te ortakut te vetem.

Ortaku i Vetem vendos per sistemin e administritimit dhe ne rastin e nje organi administrativ ne rast se jane me shume se nje administrim,percakton numrin e tyre dhe kompetencat e tyre.

Administratori/et mund te jene ose jo ortake.

Administratori mund te shkarkohet ne cdo kohe.

Administrator i shoqerise eshte Z.Ervin Celaj me nje afat 5-vjecar.

Administratori do te ushtroje kompetencat e tij per nje periudhe 5 vjecare sipas ligjit.

## NENI 12

### Kompetencat

Shoqeria administrohet nga nje ortak i vetem. Administratori ka te drejte te kryeje te gjitha veprimet e administritimit te zakonshem e te jashtezakonshem. Administratori perfaqeson shoqerine perpara te gjithe personave fizike e juridike publik dhe/ose privat vendas apo te huaj, autoriteteteve shteterore shqiptare apo te huaja perfshi ketu autoritetet gjyqesore te te gjitha shkallevet.

Administratori ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne maredhenie me te tretet ne emer te shoqerise ne te gjitha rrrethanat me perjashtim te kompetencave qe ligji ia jep ortakeve te shoqerise.

Administratori angazhon shoqerine ne maredheniet me te trete nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e saj.

Administratori ka gjithashtu te drejten te nenshkruaj kontrata te ndryshme ne emer e per llogari te shoqerise,perfshi ketu kontratat e qerasse shitjes blerjes a hipotekimit te pasurive te paluajtshme,te nenshkruaje akt themelimi te shoqerive te tjera ku Shoqeria eshte ortak,te nenshkruaje e te hartoje cdo dokument e te kryeje ne emer te shoqerise cdo veprim perballte bankave shqipetare apo te huaja ne lidhje me celjen apo mbylljen e llogarive rrjedhese te shoqerise,nenshkrimin e kontratave te ndryshme bankare per financimin e shoqerise si dhe te kryeje veprime terheqje e derdhje shumash ne keto llogari pa limit.

Shoqeria nuk merr persiper pasojat ndaj te treteve kur ajo provon se te tretet e dinin qe akti i administratorit e kalon objektin e shoqerise apo kur te tretet nuk mund ta injoronin kete akt ne rrrethanat e dhena,duke patur parsysh faktin se vetem shpallja e statutit nuk eshte prove e mjaftueshme.

Klauzolat e ketij statuti qe kufizojne kompetencat e administratorit,te cilat rrjedhin nga ky nen,duhet te respektohen nga te tretet.

Administratorit ose ortaku qe nuk jane persona juridik nuk u lejohet te kontraktone ne cfareolloj forme qofte,te marrin hua te shoqeria,te japos pelqimin ne emer te saj,per paradigmie si dhe te behen dorezanes apo te garantojne ne emer te saj angazhimet ndaj te treteve.Ne rast te kundert kontrata eshte e pavlefshme.

### **NENI 13**

#### **Pergjegjesite**

Administratori eshte perjegjes individualisht,ndaj shoqerise ose ndaj te treteve,per shkelje te ligjeve,per shkelje statutipo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

Pasojat e marreveshjeve te pamiratuara nga ortaku i vetem qe i sjellin dem shoqerise,i ngarkohen administratorit qe ka bere marreveshjen,per te perballuar ne menyre individuale pasojat perkatese.

Pervec padise per shlyerjen e demit qe i ngarkohet personalisht administrtaorit ortaku ka te drejte te ngreje padi penale kundrejt administratorit.

Ortaku ka te drejte te ndjeke ne rruge ligjore shlyerjen e plote te demit qe I eshte shkaktuar shoqerise perfshire edhe demin financier,nese eshte e nevojshme.

Ortaku qe nuk eshte administrator, ka te drejte ne cdo kohe te informohet personalisht per veprimtarine e shoqerise dhe te njihet me llogarite dhe dokumentat e shoqerise.

### **NENI 14**

#### **Viti Financiar**

Viti financiar i shoqerise fillon me 1 janar dhe perfundon me 31 dhjetor.

### **NENI 15**

#### **Bilanci i shoqerise dhe dividentet**

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financier,Mbledhja e Ortakut te Vetem,miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Ortakut te Vetem vendos reth shperndarjes se dividentit,pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem financier sic parashikohet edhe ne ligj.

### **NENI 16**

### **Ekspertet**

Eksperti ka per detyre te kontrolloje te gjithe dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomike tregtare te shoqerise, ate gjithe vjetor dhe ate ne lidhje me kontrolllet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ortaku i vetem.

Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar perbatit reportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit finanziar vjetor si dhe ate per kontrolllet periodike te ushtruara te drejtes vendimore qe ka.

### **NENI 17**

Bilanci kontabel vjetor, miratohet mbi bazen e vendimit me shkrim nga ortaku i vetem, i cili jo vetem qe dokumenton miratimin e tyre por vendos ne lidhje me disponibiliteten e fondeve ligjore sipas nevojave te zhvillimit te metejshem te shoqerise dhe garantimin e veprimtarise se rregullit te saj, duke patur parasysh fondit te vecante te tij.

### **NENI 18**

Te Ardhurat Neto(dividenti) qe mbetet pas vecimit te fondeve ligjore te mesiperme dhe atyre per shlyerjen e cdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj te treteve, i mbesin e i kalojne ne pronesi ortakut te vetem te shoqerise.

### **NENI 19**

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe dhe per cfaredo lloj shkaku edhe para afatit per arsyen te cilin eshte krijuar sic mund te jene:

- a) Humbja e kapitalit ose pamundesia e vazhdimit te metejshem te veprimtarise se saj.
- b) Ne nje nga menyrat e parashikuara nga ligji "Per falimentin e shoqerive tregtare"
- c) Kur plotesohet afati i percaktuar per ushtrimin e veprimtarise tregtare

Ne kete rast Ortaku i Vetem merr vendimin me shkrim ne te cilin parashikon menyren e likuidimit te shoqerise duke caktuar 1 ose disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokumnet te leshuar prej tij emrin e likuidatorit dhe emrin shtese "Shoperi ne likuidim e siper"

### **NENI 20**

#### **Bashkimi e ndarja**

Shoqeria, me ane te bashkimit, mund ti kaloje trashegimine e saj nje shoqerie ekzistuese ose nje shoqerie te re qe ajo ka krijuar.

Shoqeria gjithashtu me ane te bashkimit, mund ti kaloje trashegimine e saj disa shoqerive ekzistuese ose disa shoqerive te re qe ajo ka krijuar.

Ortaku i vetem i shoqerise i cili ben kalimin e trashegimise se saj ne kuader te operacioneve te siperpermendura me lart perfiton pjesen e kapitalit themeltar nga shoqeria ose shoqerite perfituese dhe sipas rastit nje kompesim me para, vlera e te cilit nuk mund te kaloje 10% te vleres nominale te pjeseve te kapitalit themeltar te dhena.

Operacionet e permendura me lart mund te realizohen nepermjet shoqerive te formave te ndryshme. Bashkimi ose ndarja sjell prishjen pa likujdim te shoqerise qe zhduket dhe kalimin e plete te trashegimise se saj ne shoqerite perfituese ne gjendjen qe ndodhet kjo shoqeri ne momentin e realizimit perfundimtar te operacionit. Bashkimi ose ndarja sjell njekohesisht per ortaket e shoqerise qe zhduket marrjen e cilesise se ortakeve ne shoqerine perfituese sipas kushteve te percaktuara ne kontraten e bashkimit ose ndarjes.

#### **NENI 21**

Afati i emerimit te likuidatorit, publikohet sipas kushte qe percakton ligji perkates duke specifikuar dokumentat qe duhen depozituar ne Aneksin e Regjistrit Tregtar.

#### **NENI 22**

Likuidatori eshte i detyruar te jete i vemendshem dhe korrekt si per realizimin e te drejtave ndaj subjekteve ne te cilet shoqeria esht kreditor dhe per ekzekutimin e detyrimeve debive qe shoqeria ka ndaj shtetit shtetasve, te vecante apo personave fizik e juridik vendas apo te huaj.

#### **NENI 23**

#### **Baza Ligjore**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plete me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Persa nuk parashikohet ne kete statut do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per Shoqerite Tregtare", Kodi Civil dhe cfaredo lloj ligji specifik ne Republiken e Shqiperise.

#### **NENI 24**

#### **Mosmarreveshjet**

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti si dhe per cdo mosmarreveshje qe mund te linde midis shoqerise dhe te treteve do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

**NENI 25**

**Dispozita Perfundimtare**

Ky Statut u redaktua ne kater kopje me permbajtje e vlera te njejtta juridike ne gjuhen shqipe  
dhe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen Ortaku Themelues i shoqerise tregtare "**Anchor Investments**"shpk nenshkruhet ne te gjitha kopjet duke vendosur emrin,mbiemrin e firmen e saj origjinale.

ORTAKU I VETEM

( Ervin Celaj )

A handwritten signature in black ink, appearing to read "Ervin Celaj". Below the main name, there is a smaller, stylized signature that looks like "E.C." or "EC".